

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fillon Liga e Kampionëve, spektakli i garantuar
ADRESA	https://www.koha.net/futboll/fillon-liga-e-kampioneve-spektakli-i-garantuar
BURIMI	koha.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 19:43:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	7 shtator 2026, 15:43:46 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0d3ffab6e1b9b59d8e1b487ae8170f2921e138521d126d00c5852962859f5252
TEKSTI	c169029538de8fbc63b4c9788c714a2c0ed5d663b3a138f3d4b59d04c96401ef
PAMJA	8b0d489ef769deb43951d3def35cb24dac4a36d1e0cd5f397dc1b88f497fa038

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	4eb51a36ca9e089c939bbfe1568b9d251271125b95461e87ea4f24c38b784259
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	965b786ec23a8b4bb286f1d277ec370fc2da1c7624603044806722a90083ae20
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/4eb51a36ca9e089c939bbfe1568b9d251271125b95461e87ea4f24c38b784259>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Mbështete KOHËN. Ruaje të vërtetën

Kontribuo →

Letër lexuesit

FUTBOLL

Fillon Liga e Kampionëve, spektakli i garantuar



Foto: Associated Press

7 shtator 2026 17:43

Shpërndaje në:



Klikoni këtu nëse dëshironi t'i lexoni lajmet e fundit dhe të përzgjedhura në kanal in tonë zyrtar në Viber

Liga e Kampionëve fillon të martën, me pesë klube të Premier Leagues në fazën e ligës me 36 ekiye. Ekipet angleze e kërkojnë titullin e parë që nga viti 2023, pas një tjetër afati kalimtar me shpenzime të majme.

Paris Saint-Germaini ka fituar dy titujt e fundit, ndërsa që nga viti 2020 edhe Real Madridi i ka dy tituj, sa i kanë edhe skuadrat angleze. Manchester City është skuadra e fundit angleze që e fitoi garën elitare evropiane, në vitin 2023. City fillon garimin të martën, ndërsa ka mesfushë të re të vlefshme plot 440 milionë dollarë. Enzo Fernandez, Elliot Anderson dhe Ayyoub Bouaddi i kushtuan qindra miliona Manchester Cityt.

Liverpooli e pret Atletico Madridin të mërkurën. Liverpooli pagoi 125 milionë euro te PSG-ja për Bradley Barcolan dhe mund të fillojë ndeshjen me sulmin që përfshinë tre prej 13 transferimeve më të shtrenjta në histori të futbollit. Alexander Isak dhe Florian Wirtz janë dy lojtarët tjerë shumë të shtrenjtë të gjigantit anglez.

Nëntë prej dhjetë transferimeve më të shtrenjta gjatë verës janë bërë nga klubet angleze. Përjashtim ishte blerja prej 125 milionë eurosh e Yan Diomande nga Real Madridi.

Blerja më e shtrenjtë e PSG-së është mesfushoori Maghnes Akliouche, që u transferua për 50 milionë euro nga Monaco. Por blerja e tij nuk është në mesin e 30 më të shtrenjtave të afatit kalimtar të verës.

Të mërkurën PSG-ja e pret Slovan Bratislavan në fillim të rugëtimit për titull të ri të Evropës.

Edhe



Futboll • 4 nën 2025

Liga e Kampionëve vazhdon me dy superndeshje

Synimi i Parisit për suksesin e rrallë

Në epokën prej 35 edicioneve të Ligës së Kampionëve, vetëm

Arbëri.

PDK-ja nesër i drejtohet Kushtetueses

Arbëri.

Shërbimi i paralajmëruar para 7 vjetësh ende s'është tërësisht funksional

LAJMET E MBRËMJES.

PDK-ja e AAK-ja kontestojnë konstituimin e Kuvendit dhe votimin e Qeverisë

Botë.

Rusia goditi një tren pranë kufirit me Poloninë, pak pasi Boris Johnson e zyrtarë evropianë kaluan

Arbëri.

VV-ja shpall të konstituuar Kuvendin pa një nënkryetar, voton edhe Qeverinë

Futboll.

Taulant Hodaj me akuza të reja për rastin Rrahmani, FFK-ja nuk deklarohe

Real Madridi i drejtuar nga Zinedine Zidane ka tituar tre tituj rresht. Bëhet fjalë për vitet 2016, 2017 e 2018.

Ishte më e thjeshtë në formatin e vjetër të Kupës së Evropës, që ishte garë me eliminim direkt e skuadrave kampione nga ligat nacionale dhe kampionit në fuqi. Madridi i fitoi pesë finale të para, duke nisur nga viti 1956. Ajaxi dhe Bayerni i kishin nga dy tituj rresht në vitet shtatëdhjeta.

Paris Saint-Germaini është sërish pretendent për titull. Ka shtuar Ferran Torresin në ekipin e palodhshëm të drejtuar nga Luis Enrique. Torres e shënoi golin e fitores së Spanjës në finale të Botërorit ndaj Argjentinës.

PSG-ja nuk ka fituar asnjë prej katër ndeshjeve në kampionatin francez. Edhe nëse fillon ngadal në Champions, nuk do të ishte befasi. Në dy edicionet e kaluara Parisi përfundoi në vendin e 11-të dhe të 15-të në fazën e ligës, por më pas triumfoi.

Yaya Toure shkruan histori me Slovan Bratislavan

Kampioni i Sllovakisë, Slovan Bratislava, kthehet në fazën e ligës pasi i humbi të gjitha tetë ndeshjet në vitin 2024.

Mund të ketë më shumë sukses këtë herë nën drejtimin e Yaya Toure, fitues i Ligës së Kampionëve me Barcelonën në vitin 2009.

43-vjeçari nga Bregu i Fildishtë për herë të parë po punon si kryetrajner. E udhëhoqi me sukses Slovanin në tri raunde kualifikuese. Eliminoi kampionin e Gjeorgjisë, Suedisë dhe Sllovenisë për t'u bërë trajneri i parë afrikan që udhëheq një ekip në fazën kryesore të Championsit.

Ndeshjet e para

Dy ndeshjet e para të fazës së ligës në Champions luhen të martën nga ora 18:45. AEK-u e pret LASK-un austriak në Athinë, ndërsa Club Brugge e Aston Villa takohen në Belgjikë.

Prej orës 21:00 të martën janë ndeshjet Dortmund – Villarreal, Porto – Manchester City, Lille – Betis dhe Real Madrid – Inter. Pra shumë spektakël që në ditën e parë.

Mourinho lidh Madridin dhe Interin

Edhe



Futboll • 15 sht 2025

Championsi fillon të martën, pritet dramë e vërtetë

Jose Mourinho e udhëhoqi për herë të parë Real Madridin në vitin 2010, kur u largua nga Interi pasi e fitoi Ligën e Kampionëve. Mourinho është kthyer te Madridi për periudhën e dytë, 16 vjet më pas. Dhe i ka ende dy tituj të Championsit, sa i kishte edhe atëherë.

Fillimi do të jetë sfidues për madrilet, që të martën prej orës 21:00 e presin kampionin në fuqi të Italisë, Interin.

Interi është njëri prej pesë klubeve, pa llogaritur Madridin, që ka drejtuar Mourinho e që janë këtë edicion në Champions. Kampioni italian drejtohet nga Cristian Chivu, që ishte lojtar i rëndësishëm i Mourinhos në vitin 2010.

Debutuesit

Mourinho ishte trajner i Manchester Unitedit në vitin 2017, kur një klub i quajtur Sabah, u themelua në Azerbajxhan. Nëntë vjet më pas Sabah debutoi në Ligën e Kampionëve. Përballet në “Old Trafford” të enjten me Manchester Unitedin e drejtuar nga Michael Carrick, që ishte kapiten kur Mourinho ishte te ky ekip i madh anglez.

Edhe Como debutoi të enjten, kur luan ndaj Leipzigut në stadiumin e vogël në vendin piktoresk italian.

Kampioni i Austrisë, LASK-u dhe ai i Norvegjisë, Vikingu, janë debutuesit e tjerë.

Rilindja e Norvegjisë

Norvegjia arriti deri në çerekfinale të Kupës së Botës. Dhe tani ky vend i ka dy skuadra në Ligën e Kampionëve.

Vendi nordik nuk kishte skuadër në Champions për 18 vjet, deri kur Bodo/Glimti avancoi edicionin e kaluar. Dhe sërisht Bodo ka avancuar në raundet kualifikuese së bashku me Vikingun, që fitoi titullin e Norvegjisë pas 24 vjetësh.

Vikingu debuton në Stuttgart të mërkurën, ndërsa Bodo/Glimti luan me Bayernin të enjten.

Formati

Edhe

Futboll • 9 sht 2026
Enrique tregon çka i duhet PSG-së për trofeun e tretë rresht në Champions

Për edicionin e tretë Liga e Kampionëve zhvillohet në format të ri. Në fazën e ligës të gjitha 36 skuadrat i zhvillojnë nga tetë ndeshje ndaj tetë kundërshtarëve të ndryshëm. Secila skuadër i ka katër ndeshje në shtëpi e katër në udhëtim.

Pas fazës së ligës, tetë skuadrat e para në tabelë avancojnë direkt në një të tetën e finales. Ekipet nga vendi i nëntë e deri në vendin e 24-t, avancojnë, por në plejofin e fazës nokaut. Dhe ekipet nga vendi i 25-të deri në vendin e 36-të, eliminohen.

- #UEFA CHAMPIONS LEAGUE
- #LIGA E KAMPIONEVE

Artikuj të ngjashëm

Futboll • 27 gus 2026
Top-ndeshje në fazën e ligës në Champions

Futboll • 27 gus 2026
Sot shorti i Ligës së Kampionëve, caktohen vazot

KOHA

Kjo faqe kontrollohet dhe menaxhohet nga KOHA. Të gjitha materialet në të, përfshirë fotografitë, janë të mbrojtura me copyright të KOHA-s dhe për to KOHA mban të drejtat e rezervuara. Materialet në këtë faqe nuk mund të përdoren për qëllime komerciale. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar qoftë origjinal apo i modifikuar në çfarëdo mënyre, pa lejen paraprake të KOHA-s. Shfrytëzimi i materialeve nga ndonjë faqe interneti a medium tjetër pa lejen e Grupit KOHA, në emër të krejt njëjësive që e përbëjnë (Koha Ditore, KohaVision, Koha.net, Botimet KOHA, KOHA Print dhe ARTA), është shkelje e drejtave të autorit dhe të pronës intelektuale sipas dispozitave ligjore në fuqi. Të gjithë shkelësit e këtyre të drejtave do të ballafaqohen me ligjin.

- Marketing
- Politika e privatësisë
- Kushtet e përdorimit
- Udhëzim për përdorimin e IA-së
- Cilësimet e privatësisë dhe cookies

Përkthimi i përmbajtjeve në gjuhët tjera bëhet në mënyrë automatike dhe mund të ketë gabime!

+383 (0) 38 249 105 /

AL | EN | DE | FR | ES | GR | SR | TR | MK

Aneksi i ish-Radio Prishtinës (kati i parë) Xhorxh Bush p.n., 10000 Prishtinë

Shkarkoje aplikacionin e KOHËS